


DEMOKRACIA ËSHTË



ENERGJIA DIELLORE

TË GJITHË TË DREJTAT E BARABARTA

ERION (10), ENIS (9), HAXHERE (10), ANTIGONA (10), ORES (10), ALTIOR (10), DENISA (11),

LENDITA (10)

DEMOS
↓
POPULL

Unë
vendos



KRATOS
↓
UDHËHEQJE

Të gjithë jemi të barabartë, të gjithë jemi të lumtur, sepse jetojmë në shtet demokratik


Unë kam të drejtë të flas lirshëm, të shkollohem, të jem pjesë e aktiviteteve të ndryshme, të kontribuoj për vendin tim, të votoj kur të arrij moshën 18 vjeçare, etj. Tërë këtë ma mundëson shteti im. Këto të drejta nuk i gëzoj vetëm unë, por të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse shteti im është shtet demokratik. Kjo i bie se populli ka fuqinë më të madhe për të vendosur. Ky fakt na lumturon të gjithëve, sepse të gjithë

vetëm nga një person. Kjo ide nuk na pëlqeu aspak, duke ditur se bashkimi bën fuqi dhe pjesëmarrja e gjithësecilit mundëson barazi. Prandaj, sot theksuam edhe një herë se secili qytetar ka vlerën e tij dhe të drejtën për të vendosur për veten.

Kjo na lë të kuptojmë se qytetarët duhet të jenë shumë të përgjegjshëm për veprimet që i bëjnë, sepse jo çdo sjellje konsiderohet demokraci.

Andaj, bëjmë thirrje për të gjithë ju, që të kontribuoni për vendin tuaj duke u sjellur mirë me të tjerët, duke iu ndihmuar atyre, duke qenë qytetarë aktiv dhe duke promovuar vlerat demokratike. Mos harroni, demokracinë e ndërton populli, prandaj shfytëzoheni dhe përdoreni këtë sistem të vlerave.

Ne premtojmë se do të bëjmë më të mirën tonë për ta zhvilluar më tutje shtetin demokratik, sepse e dijme se pa ndihmën e popullit nuk zhvillohet demokracia. Bashkohuni edhe ju me ne, në mënyrë që të gjithë të jetojmë të lumtur.



trajtohemi në mënyrë të barabartë. Sistemi demokratik e ka përmirësuar dhe vazhdon ta përmirësoj jetën tonë. Këtë e bën duke na ofruar liri, paqe, respekt, tolerancë, bashkëpunim, barazi, solidaritet dhe çdo të mirë tjetër.

Sot në grupin tonë, biseduam se si do të ishte jeta e qytetarëve nëse nuk do të kishim të drejta të barabarta dhe sesi do të ishte jeta nëse vendi do të udhëhiqej




Demokracia na bashkon

NE JEMI QYTETARË, NE JEMI AKTIV

RIAD (10), MARIGONA (10), SADRI (10), ELMEDINA (10), ARJETA (10), FATIME (10), ORGES (10),

NARDI (11)



Ne kemi të drejtë të shkollohemi, por kemi përgjegjësi të mësojmë, t'i kryejmë detyrat e klasës dhe të shtëpisë

Ne si qytetarë të demokracisë jemi të gjithë të barabartë. Vetëm kështu mund të jemi të lumtur

Ne jetojmë në Republikën e Kosovës, e Kosova është një shtet demokratik. Në demokraci të gjithë duhet të jenë të barabartë. Edhe pse shteti ynë është demokratik, prapë se prapë ka familje me kushte më të dobëta ekonomike. Nga ne kërkohet që duhet t'i ndihmojmë, sepse solidariteti është një element i demokracisë. Në demokraci ne kemi shumë të drejta.

Disa nga të drejtat tona janë: e drejta e shkollimit, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e argëtimit, e drejta e lëvizjes së lirë, etj. Shteti ynë na i siguron këto të drejta. Të drejta të cilat ne si qytetarë të Republikës së Kosovës duhet t'i përdorim.

E drejta e shkollimit është një e drejtë shumë e dashur për ne. Sigurisht se ne e shfrytëzojmë këtë të drejtë dhe i ftojme të gjithë moshatarët tanë të veprojnë

njëlloj sikurse ne.

Me shkollimin tonë ne kontribuojmë në demokraci. Disa nga përgjegjësitë tona janë: të ruajmë ambientin, të respektojmë njëri-tjetrin, të respektojmë ligjet, të votojmë, të paguajmë taksat, etj.

Qytetarët aktiv mund ta ruajnë shëndetin e tyre dhe të tjerëve, duke mos hedhur mbeturina në tokë dhe duke e mbajtur ambientin pastër. Po ashtu, si qytetarë që jemi, duhet të jemi të kujdesshëm që të mos ndezim zjarr dhe të mos keqpërdorim ajrin tonë. Ne në klasën tonë tash e disa vite, pastrojmë klasën në fund të orarit mësimor. Në këtë mënyrë jemi më rehat kur mësojmë.

Fëmijët duhet të jenë të lumtur, ata meritojnë të jenë të shëndetshëm, të ndihen të sigurtë dhe të jenë të arsimuar, sepse fëmijët janë e tashmja dhe e ardhmja e vendit tonë.



Gazetarët shumë aktiv gjatë punës



Autorët e artikullit

PESHA E VOTËS NË DEMOKRACI

ELIJESA (10), ALMEDINA (10), VALON (10), FATLIND (10), ALEJNA (10), DRENUSHA (9), ENESA (10),

DJELLOR (10)

Në demokraci vlera e zgjedhjeve është shumë e madhe. Përmes tyre na mundësohet të zgjedhim diçka që neve na pëlqen, jo t'i nënshtrohemi asaj që nuk e duam

Pa zgjedhje të lira nuk ka as demokraci të mirë. Këtë vazhdojnë të na e thonë arsimtarët në shkollën tonë. Ata, vazhdimisht na tregojnë që nëse Kosova nuk do të ishte vend demokratik, pa dyshim që edhe qytetarët nuk do t'i gëzonin të gjitha këto të drejta që sot i gëzojnë. Një ndër to është edhe e drejta e votës, e cila ka peshë dhe vlerë shumë të madhe. Qytetarët përmes votës vendosin të ardhmen e tyre dhe po ashtu edhe të ardhmen e vendit tyre. Ata fuqinë dhe pushtetin që kanë, e delegojnë tek përfaqësuesit.

Këta përfaqësues marrin vendime për të mirën e të gjithë qytetarëve. Kur themi qytetarëve, mendojmë edhe për ne, fëmijët. Edhe pse ne jemi ende të vegjël dhe nuk kemi të drejtë vote, janë prindërit tanë ata që mendojnë edhe për neve kur votojnë. Ata votojnë për kandidatët të cilët premtojnë arsim më të mirë, tro-tuare, ndriçim, e shumë të tjera. Ngase, këto çështje ndikojnë edhe tek të rriturit por edhe tek ne.

Kur jemi te prindërit, kishim dashur t'iu tregojmë që të gjithë prindërit e fëmijëve të moshave tona pa asnjë dallim, kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin zgjedhor. Por jo vetëm prindërit, këtë të drejtë e gëzon çdo person mbi moshën 18 vjeçare. Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet lokale dhe ato qendrore. Tash do t'iu informojmë pse kanë rëndësi zgjedhjet për fëmijët, si dhe disa nga zgjedhjet që ne i bëjmë në klasën tonë.

Së pari, me anë të zgjedhjeve ne e bëjmë më të lehtë jetën tonë, ose përditshmërinë tonë. Një shembull konkret i kësaj është zgjedhja e kryetarit të disiplinës në klasën tonë. Zakonisht çdo klasë ka një kryetar të klasës dhe nënkryetarin. Kurse, klasa jonë ka disa kryetarë, kryetarin i klasës, kryetarin e edukatës fizike, kryetarin e disiplinës, etj. Ky i fundit është përgjegjës për disiplinën në klasë. Përpos këtij shembulli, ne bëjmë edhe disa zgjedhje të tjera, si për lojë se çfarë loje do të luajmë. Ne, po ashtu kemi edhe kryetarin e edukatës fizike.


Të gjithë këta kryetarë janë të zgjedhur nga vullneti ynë. Për këtë janë të rëndësishme zgjedhjet, sepse përmes tyre ne e rrisim mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Në rastin tonë të të gjithë nxënësve të klasës.



Grupi ynë gjatë punës




Zgjedhjet e ndryshme të shokëve tanë



Të gjithë kryetarët e klasës janë zgjedhur nga ne

KUVENDI, SHTËPI E QYTETARËVE

SUELA (10), ERISON (10), QËNDRESA (10), ADIAN (10), VLERA (10), ERMAL (10), ERZA (10), AMAR (11)



Kjo është salla në të cilën mbahen seancat plenare

Punë kryesore e deputetëve është të na përfaqësojnë neve dhe të miratojnë ligje të mira

Në shtetin tonë, ekziston një shtëpi e madhe, në të cilën punojnë disa persona të rëndësishëm. Kjo shtëpi quhet Kuvend dhe personat të cilët punojnë aty quhen deputetë. Në Kuvend, gjithsej punojnë 120 deputetë, të cilët i përfaqësojnë interesat tona, dhe për këtë arsye Kuvendi e ka funksionin përfaqësues. Kuvendi



e ka edhe funksionin legjislativ, me ç'rast deputetët miratojnë apo nuk miratojnë ligje. Këto ligje, mund të jenë për arsim, për shëndetësi apo për çfarëdo lloj natyre tjetër që në një formë apo në tjetër ndikojnë jetën tonë. Funksioni i tretë është ai kontrollues, sepse deputetët e monitorojnë apo e kontrollojnë punën të cilën e bën Qeveria. Sot, kuptuam se Kuvendi ka ndikim të madh në jetën tonë, sepse për çdo pakënaqësi tonën, tani ne e dijmë se kujt t'i drejtohem.

Po e tregojmë një rast ku e dëshmohet marrëdhënia jonë me Kuvendin e Kosovës, me një letër drejtuar një deputeteje. Lexoni në vijim.

„Shumë e nderuar deputete e Republikës së Kosovës. Ne jemi një grup nxënësish nga shkolla „Hilmi Rakovica“, dhe me ju dëshirojmë ta ndajmë një shqetësim tonin. Shqetësimi ynë është se ditëve të fundit temperaturat kanë zbritur dhe nxemjet në shkollën tonë nuk funksionojnë. Që të mos sëmuremi, ne kërkojmë nga ju që të merrni masa dhe ta zgjidhni këtë problem në tërë shkollat e Kosovës. Shpresojmë se së shpejti shqetësimi ynë do të zhduket, e bashkë me të edhe të ftohtit në klasët tona“.

Bashkëmoshatarë të dashur, edhe ju njëjtë sikurse ne mund t'i ndani shqetësimet dhe brengat me deputetët e Republikës së Kosovës, sepse mirëqenia jonë është më se e rëndësishme për ta.



Fytyrat tona të lumtura, janë rezultat i punës së përfaqësuesve tanë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Hitmi Rakovica“
Klasa: V-1
Vendi: Prishtinë